

RELACION

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT NORMATIV DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Akti normativ “Për disa shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar” është hartuar në kuadër të plotësimit të paketës ligjore dhe bazuar në nenin 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën.

Objektivi kryesor që synohet të arrihet me anë të këtij ndryshimi është përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat për shtetasit e huaj dhe shtetasit e huaj me origjinë shqiptare që përfitojnë pension, si kusht lehtësues për vendqëndrim në territorin e Republikës e Shqipërisë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky akt normativ hartohet në përputhje me programin politik të qeverisë shqiptare, angazhimin e saj për përmbushje të standardeve ndërkombëtare, si dhe në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Diasporën.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky akt normativ ka për qëllim përcaktimin dhe zbatimin e normave për përjashtimin nga tatimi mbi të ardhurat për shtetasit e huaj dhe shtetasit e huaj me origjinë shqiptare që përfitojnë pension, me vendqëndrim në territorin e Republikës e Shqipërisë. Duke realizuar këtë qëllim, qeveria shqiptare zgjeron hapësirën e lehtësimeve e të mundësive për shtetasit e huaj dhe shtetasit e huaj me origjinë shqiptare për të zgjedhur Shqipërinë si vendbanimin e tyre pas daljes në pension.

Efektet e pritshme të aktit normativ janë përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare ose shtetasit e Bashkimit Evropian me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, të cilët marrin pension sipas legjislacionit të vendit ku e përfitojnë atë dhe shtetasit e huaj, të cilët kanë përfituar shtetësinë shqiptare me vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë.

Zbatimi i aktit normativ pritet të ndikojë në rritjen e lëvizjes së shtetasve të huaj në drejtim të Shqipërisë, forcimin e lidhjeve të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë me vendin e origjinës, rritjen e kërkesës për shërbime në nivel vendor, zhvillim të ofertës për shërbime, kujdes e turizëm.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Akti normativ “Për disa shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”, është hartuar në kuadër të plotësimit të paketës ligjore dhe bazuar në nenin 101 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky akt normativ nuk lidhet më çështje specifike të përafrimit të legjislacionit me *acquis communautaire*. Ai është bazuar në të drejtën për lëvizje të lirë të personave, e garantuar në legjislacionin e Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Akti normativ është konceptuar me ndryshimet e reflektuara, si më poshtë vijon:

Në nenin e parë të aktit propozohet shtimi i pikës 1/1 në nenin 8/1, të ligjit, ku përkufizohen të ardhurat që përjashtohen nga tatimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare ose shtetasit e Bashkimit Evropian me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, të cilët marrin pension sipas legjislacionit të vendit ku e përfitojnë atë; shtetasit e huaj, të cilët kanë përfituar shtetësinë shqiptare me vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë. Mënyra e përfitimit për këto kategori përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në nenin 2 parashikohet se pas nenit 8/1, të ligjit, shtohet neni 8/2, i cili parashikon kushtet e përfitimit nga përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat, me këtë përmbajtje:

1. Për të përfituar nga përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat, personat përfitues sipas pikës 1/1, të nenit 8/1, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
 - a) Të jenë përfitues të pensionit sipas legjislacionit në fuqi në vendet ku e kanë përfituar atë;
 - b) Të jenë pajisur me leje qëndrimi në territorin e Republikës së Shqipërisë;

- c) Të mos kenë qenë ndonjëherë të dënuar në shtetin e vet apo në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë shtet tjetër për vepra penale, për të cilat ligji parashikon dënime me jo më pak se 3 (tre) vjet heqje lirie;
 - ç) Të kenë marrë përgjigje pozitive nga struktura përgjegjëse administrative për përjashtim nga tatimi mbi të ardhurat personale të përfitimit të pensionit. Kërkesa e palëve të interesuara duhet të shoqërohet me dokumentet provuese për parashikimet e shkronjave “a”, “b” e “c”, të kësaj pike, si dhe një kopje të pasaportës së tyre të lëshuar nga shteti ku kanë vendbanimin e përhershëm.
2. Strukturat e organeve tatimore janë përgjegjëse dhe garantojnë trajtim të barabartë të çdo kërkesë të depozituar nga palët e interesuara për të qenë përfitues nga zbatimi i këtij ligji. Në rast përgjigjeje negative ose të mungesës së përgjigjes nga struktura përgjegjëse administrative, brenda afateve ligjore të parashikuara, palës së interesuar i lind e drejta për ankimim administrativ sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.
3. Personat përfitues sipas pikës 1/1, të nenit 8/1, të këtij ligji, humbasin të drejtën e përjashtimit nga tatimi mbi të ardhurat në kushtet e mosripërtëritjes së lejes së qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, kur për këtë nuk është bërë kërkesë në strukturat përgjegjëse deri 6 (gjashtë) muaj nga data e mbarimit të lejes. Në rast përgjigjeje negative ose të mungesës së përgjigjes nga struktura përgjegjëse administrative, brenda afateve ligjore të parashikuara, palës së interesuar i lind e drejta për ankimim administrativ sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij akti normativ ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe ministri i Shtetit për Diasporën.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Për hartimin e aktit normativ ka kontribuar grupi i punës i Ministrit të Shtetit për Diasporën.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky akt normativ nuk ka efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE